VENDIM
Nr. 412, datë 1.6.2016

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RISHIKIMI I PROJEKTIT TË ZBATIMIT TË FAZËS SË PARË TË VIJËS BREGDETARE TË QYTETIT TË VLORËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rishikimi i projektit të zbatimit të fazës së parë të vijës bregdetare të qytetit të Vlorës".
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë "truall" dhe "ndërtesë", me vlerë të përgjithshme prej 68 483 455.76 (gjashtëdhjetë e tetë milionë e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë e pesë pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 68 483 455.76 (gjashtëdhjetë e tetë milionë e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e katërqind e pesëdhjetë e pesë pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga llogaria "Fondi i shpronë-simeve", në Bankën e Shqipërisë. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.
5. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.
6. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Vlorë.
7. Brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.
8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.
9. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe Bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

LISTA E PASURIVE TË PALUAJTSHME QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT "RISHIKIM I PROJEKTIT TË ZBATIMIT TË FAZËS SË PARË TË VIJËS BREGDETARE TË QYTETIT TË VLORËS"

Nr.	Pronari	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqe trualli	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i truallit lekë/m²	Vlera e truallit lekë	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera truall dhe ndërtesë	Shënime
1	Lumturi Varfi Vladimir Varfi	8602	36/122/2	250.00		10.903	2.725.750	0,00	2.725.750	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë
2	Lumturi Varfi Vladimir Varfi	8602	36/123/ND		311,00		0,00	12982239	12.982.239	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Urdhër kufizimi
3	Turi Aligjoni Flavia Aligjoni	8602	36/125	299.92	330,00	10.903	3.270.028	13.871.630	17.141.658	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Objekti është ndërtesë dykatëshe. Urdhër kufizimi
4	Ilir Bircaj Vasil Bircaj	8602	40/88/ND		713,00		0,00	29.613.299	29.613.299	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë. Sekuestro konservative
5	Batjar Bazaj Luiza Xhaho	8602	36/191/ND		31,89		0,00	618.577	618.577	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Vlorë
6	Posedohet nga Ilir dhe Vasil Bicaj (karburant)	8602			362,00			5.401.933	5.401.933	Kompensimi për efekt shpronësimi të objektit kryhet pasi të jetë paraqitur dokumentacioni i plotë i pronësisë së objektit pranë Bashkisë Vlorë
							TOTALI		**68.483.455,76**	

Në pasurinë nr. 40/89, e llojit "truall", me pronar "shtet", shpronësohet objekti mbi truall me leje ndërtimi në posedim nga Ilir dhe Vasil Bicaj.